

INTERESI PUBLIK DHE KUFIZIMET E SË DREJTËS SË INFORMIMIT

Ligji për të Drejtën e informimit në Shqipëri rregullon të drejtën për të marrë informacion/dokumente të mbajtura nga autoritetet publike. Synimi është promovimi i transparencës dhe llogaridhënies së autoriteteve publike.

Sipas legjislacionit, 'Informacioni publik' përkufizohet si: 'çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik'.

Çfarë nënkupton "interesi publik" ?

Interesi publik nënkupton të mirën publike.

Kushdo ka të drejtë të kërkojë informacion publik, por ligji parashikon disa rrethana kur aksesimi në informacion mund të kufizohet.

Autoritetet publike mund t'u duhet të përcaktojnë nëse kërkesa të caktuara për informacion duhet të refuzohen apo nëse interesit publik i shërbehet më mirë duke përmbyshur kërkesën.

A mund të kufizohet e drejta për informim?

Po, në rrethana të caktuara, e drejta e informimit mund të kufizohet. Vendimi për kufizimin e informacionit mund të merret nëse ju ose autoriteti juaj vendosni se dhënia e informacionit do të shkelë:

- të drejtën për privatësi
- sekretet tregtare
- të drejtën e autorit
- patentat

Këto kufizime nuk zbatohen nëse është marrë miratim nga titullari i të drejtave për dhënie e informacionit ose kur titullari i të drejtave konsiderohet Autoritet Publik.

Autoritetet publike janë përgjegjëse për përcaktimin nëse kërkesa për informacion refuzohet apo nëse interesi publik është më i lartë për përmbyshjen e kërkesës.

E drejta e informimit mund të kufizohet edhe kur dhënia e informacionit mund të cenojë:

- sigurinë kombëtare, referuar përkufizimit nga legjislacioni për informacionin e klasifikuar;
- parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale;
- mbarëvajtjen e hetimit të shqyrtimit administrativ në kontekstin e procedimeve disiplinore;
- ecurinë normale të procedurave të inspektimit dhe auditimit për organet e sektorit publik;
- politikat monetare dhe fiskale të shtetit;
- barazinë e palëve në një proces gjyqësor dhe ecurinë normale të procesit gjyqësor;
- konsultimin paraprak ose diskutimet e brendshme në organet e sektorit publik për hartimin e politikave publike;
- mbajtjen e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe ndërqeveritare.

Kërkesa për informacion nuk duhet të refuzohet për sa kohë ekziston interes publik më i lartë që informacioni të jepet.

Shembuj:

Nëse:

Shqyrtimi administrativ përsa u përket procedimeve disiplinore dhe procedurave të inspektimit dhe auditimit të organeve të sektorit publik është kryer.

Atëherë:

Ju dhe autoriteti juaj nuk duhet të kufizoni informacionin duke përdorur arsyetimin se do të ndikojë “ecurinë normale të shqyrtimit administrativ sa u përket procedimeve disiplinore dhe ecurinë normale të procedurave të inspektimit dhe auditimit për organet e sektorit publik”.

Nëse:

Kërkesa ka të bëjë me të dhëna teknike ose të dhëna statistikore.

Atëherë:

Ju dhe autoriteti juaj nuk duhet të kufizoni informacionin duke përdorur arsyetimin se do të ndikojë “politikat monetare dhe fiskale të shtetit” ose “barazinë e palëve në procese gjyqësore dhe ecurinë normale të proceseve gjyqësore”.

Nëse:

Kërkesa ka të bëjë me politika që janë publike.

Atëherë:

Ju dhe autoriteti juaj nuk duhet të kufizoni informacionin duke përdorur arsyetimin se do të ndikojë “konsultimin paraprak ose diskutimin e brendshëm në organet e sektorit publik për hartimin e politikave publike”.

Ku mund të këshillohem për vendimin e refuzimit të një kërkesë për informacion?

Duhet t'i referoheni gjithmonë kufizimit të parashikuar nga ligji përpara se t'i përgjigjeni kërkesës. Seksioni përkatës për këtë çështje është neni 17 i Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Nëse keni pasiguri lidhur me bazën ligjore të përgjigjes, mund të konsultoheni me Urdhrat e mëparshëm të Komisionerit të publikuara në faqen tonë të internetit www.idp.al. Nëse ende keni pasiguri dhe ju nevojitet informacion i mëtejshëm, mund të kërkonti opinionin zyrtar të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në buletin mjor diskutohen më me detaje disa nga vendimet, ndaj sigurohuni të jeni regjistruar për ta marrë.

A ishte i dobishëm ky informacion? Nëse mendoni se duhet të shtojmë diçka tjetër te ky udhëzues, ju lutemi të na shkruani: info@idp.al